



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Me të cilin vërtetoj se nga Zyra e Komisionit të Pavarur për Media kam pranuar shkresën:

With this I confirm receipt the official document from the Office of Independent Media Commission:

Emri dhe numri i referencës:
Name and reference number:
Ime i broj referencije

KTV
Flaka Surroi
Drejtoreshë
Prishtinë

data 27.10.2015
date:
datum

Prishtinë

Ref: 1510/1286/KPM/a.m.

Esool Lashuri

[Signature]

Emri i përfaqësuesit të KPM

Nënshkrimi i përfaqësuesit të KPM

Name of IMC representative

Signature of IMC representative

- Gani Tenezi doli

- [Signature]

Emri i pranuesit dhe data
Name of Recipient and date

Nënshkrimi i pranuesit data dhe ora
Signature of Recipient date and time

Vendi/Place

Data dhe ora /Date and time:

Prishtinë⁹
KTV-80⁹

27/10/2015¹



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KTV
Flaka SURROI
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2015/165 KPM vs KTV
Ref:1510/1286/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2015/165 – Komisioni i Pavarur i Media (KPM) kundër KTV (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse me datën 28 gusht 2009, është pajisur me licencë afatgjate të KPM-së. Me marrjen e licencës, Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga KPM
2. KPM, me datë 8 qershor ka pranuar një ankesë nga operatori kabllor IPKO të parashtuar kundër Palës Përgjegjëse lidhur me transmetimin pa të drejta të autorit të përmbajtjeve programore sportive në kuadër të programeve sportive të marra nga Super Sport Kosova (SSK), për të cilat vetëm IPKO e ka të drejtën e transmetimit në territorin e Republikës së Kosovës.
3. KPM qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Rregulloren për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse me datën 10 qershor 2015. Gjatë monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar sekuenca të ndeshjeve të transmetuara në Super Sport, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores KPM -2013/02, si dhe ka transmetuar material të pjesshëm pa deponuar një marrëveshje të vlefshme për të drejtat e autorit, duke tejkaluar standardin prej 90 sekondave duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02.
4. KPM, bazuar në shkeljen e Rregullores KPM-2013/02, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 30 qershor 2015, Palës Përgjegjëse i ka dërguar Njoftim për Shkelje, me të cilin ka kërkuar

që të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/02, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse për shkeljet e bëra.

5. KPM, me datën 6 korrik 2015, ka pranuar një përgjigje në mënyrë elektronike nga Pala Përgjegjëse, e cila mossjelljen e kontratave e justifikon me faktin se ka bërë marrëveshje gojore me përgjegjësit e SSK për transmetim të përmbajtjeve programore sportive në kuadër të programeve sportive të marra nga Super Sport Kosova, duke mos e kontestuar transmetimin e përmbajtjeve programore sportive pa marrëveshje për të drejtën e transmetimit.
6. KPM, edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse nga data 2 deri me 4 gusht 2015. Bazuar në raportin e monitorimi të datës 18 gusht 2015, është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/02, duke transmetuar seriale dhe dokumentar pa siguruar marrëveshjet për të drejtat e autorit. Serialët dhe dokumentarët të gjetur gjatë ditëve të monitorimit janë: "Dance Academy" "Lazy Town" "Pallati", "Brazil Red", "Mystery Files Cleopatra", "Mystery Files Nostradamus" "Uttaran", "Al Capone Scarface", "Mysteri Files Robin Hood", "Biography: Pablo Picaso pjesa e parë" "Dila Hanim", "Mariana & Scalett", "Biography: Eric Clapton" dhe Biography: Pablo Picaso pjesa e dytë".
7. KPM duke u bazuar në raportin e monitorimit me datë 5 gusht 2015, i ka dërguar Palë Përgjegjëse një kërkesë, që në afat prej pesë (5) ditësh t'i sjellin kopjet e kontratave valide për të drejtën e autorit, në mënyrë që të dëshmon se posedon të drejtën e transmetimit të serialeve dhe dokumentareve.
8. KPM, pas dërgimit të kërkesës ka pranuar disa kopje të kontratave përmes të cilave Pala Përgjegjëse dëshmon se posedon të drejtën e transmetimit për këto seriale: "Dance Academy", "Biography: Pablo Picaso", "Biography: Eric Clapton", "Mystery Files Nostradamus", "Al Capone Scarface", "Brazil Red", "Uttaran", "Pallati" dhe "Dila Hanim". Ndërsa Pala Përgjegjëse vazhdon t'i transmetojë pa të drejtë autoriale serialët: "Lazy Town" "Mariana & Scalett", dhe dokumentarët "Mystery Files Cleopatra" dhe "Mysteri Files Robin Hood".

Analiza Ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Medieve bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2, nenit 6, paragrafi 1, dhe nenit 7 të Rregullores KPM-2013/02.

Nenit 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/02 "Detyrimet për të Drejtën e autorit", përcakton se:

"Të licencuarit i kërkohet të veprojë në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta 04/L-065 si dhe ligjet tjera në zbatim në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë marrëveshje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë

programeve komerciale. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që rrjedhin nga sateliti. Në rastin kur programi konsiderohet i zotërimin publik, prodhimi i të cilit është më i vjetër se 70 vjet, nuk kërkohet një leje e tillë.”

Neni 4, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2013/02 përcakton se:

“I Licencuari obligohet që t’i sigurojë KPM-së kopje të marrëveshjeve për këto të drejta brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i kërkesës me shkrim.”

Neni 6, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/02 përcakton se:

“Informacioni i shkurtër, sipas këtij neni, nënkupton njoftimin i cili zgjat 90 sekonda më së shumti dhe i cili është i paraqitur si pjesë e programit informativ”.

Neni 7, i Rregullores KPM-2013/02 përcakton se:

“Transmetimi i tërësishëm apo i pjesëve të konsiderueshme të materialeve në video, audio ose tekstuale që janë objekt i mbrojtjes së autorit, duke tejkaluar standardet e informimit të publikut të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje, lejohet vetëm në kuadrin e një kontrate të vlefshme me pronarin e të drejtave të autorit ose me shitësin e autorizuar ligjërisht për materiale të tilla”.

10. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, nenin 6, paragrafi 1 dhe nenin 7 të Rregullores KPM-2013/02, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë ritransmetimin e përmbajtjeve pa të drejtë autoriale.
11. Komisioni i KPM-së duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, nenin 6 paragrafi 1 dhe nenin 7 të Rregullores KPM-2013/02, duke transmetuar programe sportive, seriale dhe dokumentare pa të drejtë autoriale.
12. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje dhe Kërkesës të dërguara nga KPM, përmes të cilave i është bërë me dije se është në shkelje të Rregullores KPM-2013/02, në mënyrë të vazhdueshme ka bërë transmetim të filmave pa të drejtë autoriale.
13. Komisioni i KPM-së, si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse merr shkeljet e vazhdueshme edhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri.
14. Komisioni i KPM-së, si rrethanë lehtësues në këtë rast merr për bazë faktin se Pala Përgjegjëse, bazuar në monitorimin e datës 18 gusht 2015, për 9 seriale dhe dokumentare ka siguruar marrëveshje për të drejtën autorial, ndërsa mbetet në shkelje për 4 përmbajtje programe, 2 seriale dhe 2 dokumentare.

15. Komisioni i KPM-së, duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2, nenit 6 paragrafi 1, dhe nenit 7 të Rregullores KPM-2013/02, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë transmetimin e përmbajtjeve programore sportive, seriale dhe dokumentarë, pa të drejtë autoriale.

Vendimi


16. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 7, të Rregullores KPM-2013/02.
17. Komisioni, vendosi që në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse të sanksionohet me Vërejtje për shkeljen të vazhdueshme të nenit 4, paragrafi 1, nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 7 të Rregullores KPM-2013/02.

E drejta për Ankesë

18. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
19. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave

27.10.2015
datë